



## FUTUR EN TOUS GENRES

Nouvelles perspectives pour filles et garçons

### **Ardhshmëria e të gjitha gjinive (Dita Kombëtare e Ardhshmërisë) - çfarë duhet të dini**

Qëllimi i Ditës së Ardhshmërisë së gjitha gjinive (Dita Kombëtare e Ardhshmërisë) është hapja e horizonteve profesionale e nxënësve dhe nxënëseve, në mënyrë që ata të zbulojnë profesionet atipike. Me këtë rast, qindra kompani, organizata, shkolla profesionale dhe shkolla të larta hapin dyert e tyre në tërë Zvicrën. Vajzat dhe djemtë në moshë 7 - 9 HarmoS për kantonin e Bernës, 9 HarmoS për kantonin e Neuchâtel-it, la 8 HarmoS për Valais, 7 - 10 HarmoS për Frajburg, dhe 7 në Gjenevë ftohen që të shoqërojnë një të afërm të gjinisë së kundërt në vendin e punës ose të marrin pjesë në një seminar ngacmues. Në pajtim me devizën "ndryshimi i perspektivës", ata dhe ato zbulojnë profesionet, karriera dhe fusha të punës që janë atipike, duke siguruar përjetimin e shumëllojshmërisë.

A keni një djalë apo një vajzë që mund të marrë pjesë në këtë projekt? Përdorni këtë mundësi dhe shikoni shanset që fëmija juaj do të ketë:

#### **1. Programi bazë: vajzat dhe djemtë shoqërojnë një të afërm në vendin e punës.**

Pjesëmarrja e kryqëzuar është pika kryesore e programit bazë. Megjithatë, ka disa variante të mundshme:

- Vajzat e shoqërojnë babain e vetë dhe djemtë nënat e veta (ose një person të afërt);
- Vajzat shoqërojnë një person që punon në një profesion tradicionalisht mashkullor, ndërsa djemtë shoqërojnë dikë që ka një profesion tradicionalisht femëror.

#### **2. Seminaret tematike: vajzat dhe djemtë zgjedhin një seminar praktik.**

Shumë ndërmarrje, organizata, shkolla profesionale dhe shkolla të larta ofrojnë seminare tematike në fushën profesionale atipike për djem dhe vajza. A dëshiron fëmija juaj të marrë pjesë në një seminar? Ja çfarë duhet të bëni:

- Ju do të gjeni informacion praktik në [www.futurentousgenres.ch](http://www.futurentousgenres.ch), në seksionin "ateliers/inscriptions".

## **Informatat praktike**

### **Lidhur me vendin tuaj të punës**

Pyetni punëdhënësin nëse fëmija juaj mund të vijë në vendin e punës për të zbuluar profesionin tuaj me rast të ditës së "Ardhshmërisë së të gjitha gjinive" (Dita Kombëtare e Ardhshmërisë). Mos harroni të informoni kolegët tuaj, menaxhimin dhe departamentin e burimeve njerëzore. Shumë kompani/institucione ofrojnë programe të veçanta me këtë rast.

### **Lidhur me shkollë**

Në rast se fëmija juaj dëshiron t'ju shoqërojë në vendin e punës ose të marrë pjesë në një seminar tematik, duhet të plotësoni një [justifikim shkollor](#), të cilin fëmija juaj do t'ia japë mësuesit/mësueses. Nëse klasa e fëmijës suaj nuk merr pjesë në ditën e ardhshmërisë, ai ose ajo do të ketë mundësi mundësi të marrë pjesë në aktivitete tematike në klasë.

### **Përgatitja për Ditën e Ardhshmërisë së të Gjitha Gjinive (Dita Kombëtare e Ardhshmërisë)**

Përgatituni për Ditën e Ardhshmërisë së të Gjitha Gjinive (Dita Kombëtare e Ardhshmërisë): Cilën punë fëmija juaj dëshiron të zbulojë? Asgjë nuk është më ngacmuese sesa të diskutoni së bashku të gjitha këto tema të ndryshme. Një listë e plotë që do t'ju ndihmojë të përgatiteni për ditën e ardhshmërisë mund të gjendet [këtu](#).

### **Intervistat**

Pyetni një koleg(e) nëse ai ose ajo është i gatshëm/e gatshme të përgjigjet në disa pyetje të fëmijës suaj. Qëllimi i Ditës së Ardhshmërisë është që vajzat dhe djemtë të zbulojnë sa i madh është numri i profesioneve ekzistuese. Pastaj, zgjidhni me kujdes një person që ka një profesion atipik ose të panjohur për fëmijën tuaj. Një [Shabllon interviste](#) mund të shkarkohet.

### **Pyetëtori i vlerësimit**

Në fund të Ditës së Ardhshmërisë, kërkonte nga fëmija juaj që të plotësojë [PyetëSORIN e Vlerësimit](#) për ditën e "Ardhshmërisë së të gjitha gjinive" (Dita Kombëtare e Ardhshmërisë) dhe e dërgoni në qendrën e koordinimit të ditës së [Ardhshmërisë së të gjitha gjinive](#).